

Rizgjimi i Islamit nëpërmjet tendencave të *Texhdid-it* (Ripërtëritjes) dhe *Islah-ut* (Reformimit) në Shqipërinë post-komuniste

Fatmir Shehu
Bukuri Zejno

Abstrakti

Ky artikull shqyrton rizgjimin e Islamit në Shqipëri nëpërmjet tendencave të *Texhdid-it* (ripërtëritjes, rinovimit) dhe *Islah-ut* (reformimit), të kryera nga Komuniteti Musliman Shqiptar dhe intelektualët muslimanë, pas rënies së sistemit komunist në vitet 1990. Studimi synon të tregojë rolin e aktiviteteve të *Texhdid-it* dhe *Islah-ut* në rivendosjen e Islamit në Shqipërinë post-komuniste. Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në pikat kryesore të procesit të rinovimit të Islamit në Shqipëri brenda dhjetë viteve të para pas rënies së komunizmit. Ky punim fillon me një hyrje të shkurtër mbi shqiptarët dhe identitetin e tyre fetar dhe vazhdon me diskutimin e: (1) faktorëve kryesorë që çuan në *Texhdid* dhe *Islah* në Shqipërinë post-komuniste, (2) restaurimit të institucioneve arsimore islamike dhe objekteve fetare të adhurimit, dhe (3) reformimit të intelektit, identitetit dhe përkatësisë islame. Metodën e përdorur janë metoda përshkruese dhe analitike. Analiza e këtij studimi shton njohuri të reja në literaturën ekzistuese mbi prirjet e *Texhdid-it* dhe *Islah-ut* për rizgjimin e Islamit në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Texhdid* (rinovim), *Islah* (reformim), Shqipëria, post-komunizmi, identiteti fetar.

Falënderime

Ky artikull është shkruar me mbështetjen e Qendrës për Studime të Avancuara (CNS), Sarajevë. Struktura e këtij artikulli është prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare “Leximet e Bolgharit” më 25-23 Dhjetor 2018, Qyteti Bolghar, Republika e Tatarstanit, Rusi, mbështetur nga Qendra Kërkimore dhe Edukative - Akademia Islame e Bulgarit.

Hyrje

Shqiptarët jetuan të sunduar nga regjimi komunist për gati pesëdhjetë vjet, vite të cilat i izoluan ata nga pjesa tjetër e botës, duke përfshirë edhe vendet fqinje në Ballkan dhe Evropë, deri në fillim të viteve 1990. Praktikimi i fesë dhe veçanërisht i Islamit gjatë sistemit komunist ishte krejtësisht i ndaluar. E vetmja “fe” që mund të ndiqej nga shqiptarët ishte partia komuniste dhe ideologjia e saj, e cila, sipas regjimit në pushtet, përfaqësonte popullin. Përveç kësaj, u promovua dhe ideja e shqiptarizmit (e bazuar në nacionalizëm dhe patriotizëm), në bazë të së cilës të gjithë shqiptarët duhet të bashkohen pavarësisht nga dallimet e tyre fetare apo kulturore, nën moton: Feja e shqiptarit është shqiptaria. Ajo zëvendësoi fenë ku njerëzit duhej të besonin në të siç besonin më parë në Zot.

Kështu, Shqipëria ishte i vetmi vend ateist në botë, ku feja ishte krejtësisht e ndaluar për popullin e saj. Megjithatë, kalimi nga regjimi komunist në demokracinë perëndimore ose sistemin kapitalist e bëri të lehtë lidhjen e shqiptarëve me pjesën tjetër të botës. Ky tranzicion solli përfitime të tilla, si liria e shprehjes dhe e fjalës, praktikimi i fesë, liberalizimi i vizave, etj., por në të njëjtën kohë edhe dëme, si rreziku i humbjes së identitetit, kulturës, traditës dhe vlerave shqiptare, të cilat shqiptarët i konsideronin si një mënyrë për zhvillim dhe progres. Rishfaqja e fesë dhe liria e praktikimit të saj u konsideruan nga muslimanët shqiptarë si një arritje e madhe pas rënies së komunizmit.

Shqiptarët dhe sidomos muslimanët ishin në gjendje të lidheshin me Krijuesin e tyre dhe të kryenin lirisht lutjet dhe ritualet e tjera fetare. Kështu, ata u angazhuan në veprimtaritë e Texhdidit dhe Islahut për të rivendosur Islamit dhe mësimet e tij në Shqipërinë post-komuniste. Për të kuptuar më mirë rizgjimimin e Islamit nëpërmjet tendencave të Texhdidit dhe Islahut në Shqipërinë post-komuniste, autorët e konsiderojnë të nevojshme që *së pari* të diskutojnë për shqiptarët dhe identitetin e tyre fetar, si dhe faktorët që çuan në këto ndryshime. *Së dyti*, fokusi i diskutimit është vënë në strategjitë e përdorura nga Komuniteti Musli-

man Shqiptar dhe intelektualët muslimanë shqiptarë për rizgjimin e Islamit dhe mësimet e tij kryesore nëpërmjet themelimit të shumë institucioneve arsimore dhe vendeve të adhurimit, si Medresetë dhe Xhamitë, përgatitja dhe trajnimi i dijetarëve të rinj muslimanë dhe sigurimi i literaturës islame.

Kush janë shqiptarët?

Shqiptarët, sipas disa burimeve historike, janë njerëzit që kanë banuar në zonën që sot njihet si Shqipëri që nga fillimi i vendosjes së ilirëve në brigjet e Adriatikut. Ata pretendojnë të jenë pasardhës të ilirëve të lashtë, të cilët jetonin në Evropën qendrore dhe migruan në jug të Gjirit të Artës në Greqinë veriore nga fillimi i Epokës së Hekurit. Ilirët ishin një popull i lashtë indo-evropian, të cilët kanë banuar përgjatë pjesës më të madhe të historisë së tyre në gjysmën perëndimore të Gadishullit Ballkanik prej së paku 1000 (Para Krishtit).

Fisi ilir *Albanoi*, sipas gjeografit të shekullit të dytë (të erës së re), Ptolome i Aleksandrisë, banonte në malet mes Durrësit, Dibrës dhe Albanopolit . Ilirët arritën në Ballkan që në fillim të vitit 2200 (Para Krishtit) dhe gjatë gjithë Epokës së Bronzit. Ata krijuan etnicitetin dhe kulturën e tyre gjatë Epokës së Bronzit, gjë që i ndihmoi të përparonin në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Në Epokën e vonë të Bronzit, fiset e vogla ilire përparuan ekonomikisht dhe u bashkuan me njëri-tjetrin për të formuar komunitete të gjera ilire, me karakteristika të përbashkëta kulturore dhe gjuhësore. Ekonomia dhe kultura Ilire u konsoliduan pas marrjes së karakteristikave edhe më të përforcuara me themelimin e qyteteve të fortifikuara gjatë Epokës së Hekurit.

Ilirët jetonin në një shoqëri të bazuar në sistemin fisnor. Gjatë shekujve IV - II (Para Krishtit), ilirët krijuan shtetet e tyre me kështjella të forta për t'i rezistuar romakëve, të cilët synonin të zgjeronin kontrollin e tyre mbi Detin Adriatik. Për këtë, u zhvilluan disa luftra iliro-romake, të cilat filluan në 229 (Para Krishtit) dhe përfunduan në 167 (Para Krishtit) me fitoren e Romës.

Pas ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395 (të Erës së Re), territoret shqiptare iu caktuan Perandorisë Romake të Lindjes, e cila megjithatë ushtroi autoritet formal të kufizuar vetëm në zonat bregdetare, ndërkohë që brendësia u pushtua nga gothët, hunët, bullgarët dhe sllavët (shekujt IV dhe V - te Erës së Re) . Megjithëse ilirët ranë nën sundimin e grekëve dhe romakëve, ata arritën të ruajn veçanërisht besimet e tyre fetare.

Cila ishte feja e ilirëve?

Sipas historisë së fesë së shqiptarëve, paraardhësit e tyre, pellazgët, nuk kishin ndonjë paraqitje fizike të perëndive të tyre. Feja e tyre kishte natyrë jo-idhujtare të adhurimit. Ata besonin në jetën përtej varrit dhe për këtë arsye ata i varrosnin zbukurimet dhe stolitë personale bashkë me të vdekurit e tyre. Qenia Supreme e ilirëve të lashtë thirrej me emrin e zotit të vjetër indo-evropian të bubullimës, *Perëndi*. Veç kësaj, *Hen* [në gjuhën shqipe: Hëna] ose *En* është emri i një tjetër perëndie të vjetër ilire, e cila ruhet edhe sot në fjalën shqipe E Hën (e hënë). Jeta fetare e ilirëve ndryshoi krejtësisht kur grekët dhe romakët pushtuan territoret e tyre.

Së pari, grekët u prezantuan atyre sistemin fetar të idhujtarizimit të perëndive. Ata i shtuan natyrës jo-idhujtare të fesë së ilirëve artin e pikturës dhe skulpturës. Prandaj, më vonë ilirët u ndikuan prej tyre dhe filluan t'i personalizonin perënditë e tyre në shumë forma dhe mënyra. Në fenë e shqiptarëve të lashtë, pellazgëve, nuk kishte asnjë libër të shpallur apo ndonjë themelues karizmatik, dhe as nuk ekzistonte ndonjë teologji apo besim i zhvilluar që ta përkufizonte fenë e tyre. Faktikisht, feja e tyre praktikohesh në çdo shtëpi nga çdo baba, i cili shërbente si klerik i shtëpisë së tij.

Së dyti, romakët patën një ndikim të vogël fetar në Shqipërinë e pushtuar, sepse sistemi i tyre fetar nuk ishte shumë i ndryshëm nga grekët. Dallimi mund të shihej vetëm në emrat kushtuar perëndive të tyre. Për shembull, perëndia supreme romake e qiellit ishte Jupiteri, i cili korrespondonte me zotin grek Zeus. Të dyja palët, grekët dhe romakët i paraqisnin perënditë sipas imazhit të tyre.

Së treti, sipas disa burimeve historike, Krishterizmi në Shqipëri pretendon të ketë themele apostolike. Në këtë mënyrë, Krishterizmi u është prezantuar ilirëve gjatë shekullit të parë të Erës së Re, që është para se Kostandini ta shpallte atë si fenë zyrtare të Perandorisë Romake. Kjo mund të gjendet në deklaratën e Palit, në Romakët 15, vargu 19: “Nëpërmjet shenjave dhe mrekullive të fuqishme, me anë të fuqisë dhe Shpirtit të Perëndisë, që nga Jeruzalemi dhe rreth e qark deri në Iliri, kam predikuar plotësisht ungjillin e Krishtit”.

Së fundi, shqiptarët u njohën me Islamit gjatë Halifatit Osman. Gjatë kohës së Sulltan Mehmetit II Islami iu paraqit shqiptarëve zyrtarisht. Vlen të theksohet këtu se muslimanët osmanë e konsideronin sjelljen e një njeriu nën shpëtimin e Islamit si mirësinë më të madhe që ata mund të tregonin ndaj tij. Kështu, ky qëndrim kaq i mirë i bëri ata të zgjeronin territoret e Halifatit Osman jashtë mureve të Stambollit deri në Ballkan, dhe veçanërisht në Shqipëri, e cila u vu menjëherë nën mbrojtjen e Halifatit Osman. Qëndrimi i mirë i muslimanëve osmanë deri në vitin 1690 (të Erës së Re) shka-

ktoi rritjen e numrit të muslimanëve shqiptarë në 70%, përafërsisht të njëjtin raport si sot. Ata që e përfaqëuan Islamin së pari ishin familjet fisnike, të cilët më pas u ndoqën nga subjektet e tyre. Popullsia shqiptare e sotme përbëhet nga shqiptarët 95%, grekët 3%, dhe të tjerët 2% (vllahët, romët, serbët, malazezët, maqedonasit dhe bullgarët, 1989). Nga popullsia e përgjithshme, 70% janë muslimanë, 20% të krishterë ortodoksë dhe 10% të krishterë katolikë . Në bazë të statistikave të vitit 2010, numri i muslimanëve në Shqipëri është rritur me 12 përqind, i cili çon numrin e muslimanëve shqiptarë në 82.1%.

Diskutimi i mësipërm tregon se shqiptarët kanë kaluar nëpër një proces evolucionari për të krijuar një identitet unik fetar. Ata kanë përjetuar një fe të pastër jo-idhujtare, më pas fenë idhujtare greke dhe romake dhe fenë monoteiste - Islamin si një mënyrë gjithëpërfshirëse të jetës. Megjithatë, regjimi komunist që qeverisi shqiptarët për gati pesëdhjetë vjet i shkëputi ata nga Islami. Rënia e këtij regjimi në vitet 1990 u mundësoi shqiptarëve të rivendosin Islamin dhe mësimet e tij në jetën e tyre të përditshme.

Faktorët që çuan në *Texhdid* (ripërtëritje) dhe *Islah* (reformim)

Vizioni i shqiptarëve për të pasur një fe unike dhe një vend unik u bë realitet nëpërmjet ndihmës së administratës Muslimane Osmane. Qeverisja Islame u mundësoi shqiptarëve të integrojnë traditën dhe kulturën e tyre me mënyrën islame të jetesës. Ajo u ndihmoi atyre që të ruanin përkatësinë e tyre etnike, identitetin, si dhe kufijtë e saj, si shtet. Pas gjysmë shekulli përjetimi të regjimit më të rëndë komunist, i cili i ndaloi ata nga praktikimi i Islamit dhe mësimet e tij, rënia e komunizmit u ofroi muslimanëve shqiptarë mundësinë e artë për të rivendosur Islamin dhe mësimet e tij përmes tendencave të *Texhdid-it* (ripërtëritjes) dhe *Islahut* (reformimit). Më poshtë janë përmedur disa faktorë të ndryshëm që hapën rrugën për rilindjen e Islamit në Shqipëri.

Faktori i parë lidhet me *degradimin e vlerave morale në mesin e shqiptarëve gjatë dekadës së fundit të regjimit komunist*. Ky fenomen u bë i qartë pas vdekjes së kreut të Shqipërisë Enver Hoxha, i cili vdiq më 11 Prill 1985 . Gjatë viteve në vijim, shqiptarët përjetuan shumë ndryshime në të gjitha aspektet e jetës. Shumë prej tyre besonin se vdekja e Hoxhës shënoi fillimin e një epoke të re për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ekonomia e Shqipërisë u dobësua jashtë mase për shkak të degradimit të vlerave midis figurave udhëheqëse, të cilët u zhytën në korrupsion dhe abuzim të pozitave të tyre. Varfëria u bë e dukshme kudo në Shqipëri dhe veçanërisht në zonat rurale (në shumicën e fshatrave).

Faktori i dytë ishte humbja e kontrollit të qeverisë komuniste mbi institucionet arsimore. Disa intelektualë shqiptarë, të cilët gjatë regjimit komunist patën mundësinë të vazhdonin studimet e tyre universitare në vende si Franca, Rusia, Italia, etj., filluan të ushtronin në mënyrë indirekte ndikimin e tyre te studentët e Universitetit. Ata arritën të mobilizonin në veçanti studentët e Universitetit të Tiranës për të protestuar kundër regjimit ekzistues komunist. Protesta filloi më 8 Dhjetor 1990 dhe zgjati tre ditë deri më 11 Dhjetor 1990. Abrahams shpjegon se “Ndërtesat e studentëve të Tiranës, të quajtura Qyteti Studenti, shtrihen në majë të një kodre të ulët në juglindje të kryeqytetit. Në vitin 1990 ... studentët ... e shtynë fillimin e mësimit për dy javë, me justifikimin se disa ndërtesa universitare kishin nevojë për riparim ...”

Kështu ata kërkuan një takim me z. Ramiz Alia, udhëheqesin e asaj kohe, për t'i parashtruar ankesat e tyre. Figurat më të rëndësishme dhe më me ndikim në mesin e studentëve ishin Azem Hajdari, Shenasi Rama dhe Tefalin Malshyti . Ata i frymëzuan studentët dhe u dhanë atyre guximin për të mposhtur frikën që ishte e pranishme mes tyre dhe për t'ju kundërvënë regjimit.

Faktori i tretë ishte rrëzimi i ligjit për ndalimin e praktikimit të fesë në Nëntor të vitit 1990, që i motivoi muslimanët të mobilizoheshin kundër regjimit komunist. Protestat masive të organizuara nga muslimanët shqiptarë në Dhjetor të 1990 u mundësuan atyre të rihapin institucionet arsimore islame dhe vendet e adhurimit (objektet fetare) në qytetet kryesore, si Shkodra, Durrësi dhe Kavaja . Kjo ishte mundësia e artë për muslimanët shqiptarë që të themelonin qendrën e tyre të komunitetit. Kështu, në shkurt të vitit 1991 u themelua Komuniteti Musliman Shqiptar, i cili filloi menjëherë aktivitetin dhe veprimtarinë e tij. Pas këtyre ngjarjeve, muslimanët filluan të praktikojnë lirisht ritet fetare Islame. Përveç kësaj, Shqipëria u pranua nga Organizata e Konferencës Islamike si vëzhguese më 7 Dhjetor 1991. Një vit më vonë, në Dhjetor të vitit 1992, Shqipëria u bë anëtare e plotë e kësaj Organizate në një seancë të veçantë të Konferencës së Ministrave të Jashtëm të mbajtur në Xheddah më 2 Dhjetor 1992 . Anëtarësimi i Shqipërisë në këtë Konferencë i ndihmoi Shqiptarët dhe sidomos muslimanët, përveç të tjerave, në aspektin financiar.

Faktori i katërt ishte kërcënimi i madh i çrrënjësjes së identitetit të Shqipërisë pas rënies së regjimit komunist. Në të kaluarën, rreziku më i madh që i kanosej identitetit të Shqipërisë ishte ndikimi nga vlerat fetare, kulturore dhe politike helene dhe romake. Duke përqaftuar Islamin, muslimanët shqiptarë ishin në gjendje të mbronin identitetin e tyre kombëtar nëpërmjet konceptit të vëllazërisë islame. Islami i ndihmoi ata t'i rezistonin politikës së asimilimit të parashtruar nga vendet fqinje, Greqia, Serbia dhe Italia. Për të ndalur këtë lloj asimilimi, i cili u rishfaq në mënyrë edhe më agresive pas rrëzimit të sistemit komunist, Hafiz Sabri Koçi,

kryetari i parë i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, kërkoi ndihmë financiare nga vendet muslimane, si Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajti, Egjipti, Jordania, Jemeni dhe Turqia, ndihmë e cila u dha dhe u përdor për ndërtimin e institucioneve arsimore islamike dhe objekteve fetare, si dhe për të themeluar shtypin dhe shtëpitë botuese, të cilat do të siguronin dhe shpërndanin literaturën islame. Kjo u mundësoi muslimanëve shqiptarë të rivendosnin identitetin e tyre islam, përmes të cilit ata do të mund të mbronin identitetin shqiptar.

Restaurimi i institucioneve arsimore Islamike dhe objekteve fetare në Shqipëri

Pas ngjarjeve të pranimit në Organizatën e Konferencës Islamike dhe lirinë e praktikimit fetar, muslimanët shqiptarë filluan të mobilizohen. Themelimi i Komunitetit Musliman Shqiptar ishte përparësia e parë pasi ky simbolizon të vetmin organ të njohur zyrtarisht që do të përfaqësonte muslimanët brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shumë intelektualë muslimanë dhanë një kontribut të madh për këtë çështje. Megjithatë, një nga figurat më të spikatura, që vlen të përmendet këtu është Hafiz Sabri Koçi, jeta e të cilit iu dedikua zhvillimit dhe përparimit të Komunitetit Musliman Shqiptar, si dhe të jetesës së qytetarëve Shqiptarë në përgjithësi. Hafiz Sabri Koçi (14 Maj 1921 - 19 Qershor 2004), i burgosur nga regjimi komunist më 4 qershor 1966, u lirua më në fund më 22 Tetor 1986. Vuajtja e dënimit në burg për 20 vjet, 4 muaj dhe 18 ditë (ai ishte 45 vjeç kur u arrestua dhe 65 vjeç kur u lirua) nuk arriti ta bënte atë të humbiste shpresat të Krijuesit. Përkundrazi, burgu shërbeu si një vend trajnimi për përgjegjësinë e madhe që ai duhej të merrte 20 vjet më vonë¹.

16 Nëntori i vitit 1990 ishte një ditë e shënuar në jetën e muslimanëve shqiptarë dhe veçanërisht në jetën e Hafiz Sabri Koçit. Ishte dita kur ai mbajti fjalimin e parë islamik pas 20 vitesh burg. Kjo ngjarje historike që ndodhi në qytetin e Shkodrës, një fortesë e Islamit, që njihet si djepi i dijes dhe intelektualizmit islam shqiptar, u ndërmor nga të rinjtë Muslimanë të qytetit. Ata e ftuan Hafiz Sabri Koçin në Shkodër, për të ri-hapur Xhaminë e Plumbit, ku u thirr ezani dhe u krye falja e xhumasë



Hafiz Sabri Koçi
(1921–2004)

1 Shiko faqen zyrtare të Komunitetit Musliman Shqiptar, *Hafiz Sabri Koçi*, <http://www.kmsh.al/all/2013/06/hafiz-sabri-koci/>, arrihen në Prill 17, 2019.

për herë të parë pas kaq shumë vitesh. Ai u bë udhëheqësi i parë i Komunitetit Musliman të Shqipërisë nga 1990 deri në vdekjen e tij në 2004².

Viti 1990 pati sfida të shumta pasi ata “praktikisht e gjetën veten pa ndonjë strukturë fetare, përveç një numri të vogël xhamish që i mbijetuan sekularizimit agresiv”. Përveç kësaj, nga sistemi komunist mbijetuan vetëm rreth “gjashtëdhjetë anëtarë të grupit të fundit të diplomuar nga Medreseja e Përgjithshme e Tiranës”³. Kjo tregon sa shumë nevojë kishte Komuniteti Musliman Shqiptar për imamë, shkolla islamike dhe objekte fetare të adhurimit. Për këtë arsye, Sabri Koçi nisi reformën për restaurimin e institucioneve arsimore islame dhe objekteve fetare në Shqipëri. Reforma u fokusua në: (1) rihapjen e shkollave ekzistuese fetare Islamike – (Medreseve) dhe ndërtimin e shkollave të reja, (2) punësimin e mësuesve muslimanë, dhe (3) ri-hapjen e xhamive ekzistuese dhe ndërtimin e xhamive të reja.

(1) Rihapja e medreseve ekzistuese dhe ndërtimi i të reja: Për t’u mësuar bazat e Islamit muslimanëve shqiptarë, ekzistonte një nevojë urgjente për hapjen e shkollave fetare islamike. Regjimi komunist nuk i shkatërroi të gjitha shkollat fetare. Disa prej tyre u përdorën si dyqane ose vende argëtimi për të rinjtë shqiptarë të asaj kohe, ndërsa disa të tjera u kthyen në muze. Numri i shkollave fetare islamike që nuk u shkatërruan nga regjimi komunist ishte vetëm shtatë. Midis tyre ishte një Medrese në qytetin e Shkodrës, një numër medresesh të tjera në disa qytete të Shqipërisë së Mesme - Tiranë, Durrës, Kavajë, Cërrik - si dhe ato në qytetet e Beratit dhe Korçës në jug të Shqipërisë. Komuniteti Musliman u kujdes për restaurimin e këtyre medreseve dhe i ktheu ato në institucione arsimore islamike të suksesshme.

Për shembull, në qytetin e Shqipërisë Veriore, Shkodër, i njohur si djepi i Islamit, Medreseja Haxhi Sheh Shamia u hap më 12 Dhjetor 1991. Ajo filloi me dy klasa që përbëheshin nga 30 studentë secila. Në tre vitet e para ajo kishte 152 djem dhe 40 vajza. Sot ajo ka 45 klasa dhe numrin më të madh të studentëve (1100 studentë) në krahasim me të gjitha medresetë e tjera në Shqipëri⁴. Medreseja Haxhi Mahmud Dashi, e ndodhur në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, u rihap në vitin 1991. Ajo kishte 310 studentë. Medreseja Haxhi Mustafa Varoshi, e ndodhur në qytetin e Durrësit, u hap në vitin 1991. Ajo kishte dy ndërtesa të ndara, një për djemtë dhe një për vajzat⁵. Numri total i djemve ishte 78 dhe i vajzave 15. Medreseja e Hafiz Ali Korçës, e ndodhur në qytetin e Kavajës⁶, u hap në vitin 1991. Ajo kishte numrin më të madh të

2 Shiko, *Hafiz Sabri Koçi*, <http://www.kmsb.al/all/2013/06/hafiz-sabri-koci/>, arrihen në Prill 17, 2019.

3 Fikret Karčić, *The other European Muslims: A Bosnian Experience*, (Sarajevo: Center for Advanced Studies, 2015), pp. 103.

4 *Medreseja e Shkodrës, më e Madhja në Ballkan*, <https://www.trt.net.tr/shqip/kultura-dhe-arti/2018/01/24/medreseja-e-shkodres-me-e-madhja-ne-ballkan-895904>, arrihen në Prill 20, 2019.

5 *Medreseja e Vajzave në Durrës, Misioni që Bashkon Diturinë dhe Besimin*, <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=4605>, arrihen në Prill 20, 2019.

6 Autori i parë i këtij artikulli studjoi në Medresenë e Kavajës për një vit (1991), nga ku mori mësimet e para për Islamit para se të shkonte për të studjuar në Universitetin Ndërkombëtar Islamik të Malazisë, në Dhjetor 12, 1992.

studentëve 340, krahasuar me të gjitha Medresetë e tjera gjatë viteve 1991-1994. Të gjitha medresetë që u rihapën nga Komuniteti Musliman i Shqipërisë, si dhe ato që u ndërtuan të reja përdorën program mësimor të integruar - shkencat humane dhe shkencat islame⁷. Ndërtimi i medreseve ishte synimi kryesor i Komunitetit Musliman Shqiptar, i cili u arrit në një periudhë prej tre vjetësh.

(2) Rekrutimi i mësimdhënësve muslimanë: Mungesa e mësuesve muslimanë dhe e ekspertëve në lidhje me diturinë dhe shkencat islame e detyruan Komunitetin Musliman Shqiptar të ftojë mësuesit muslimanë shqiptarë, të cilët mbijetuan dhe u liruan nga regjimi, për të dhënë mësim në shkollat fetare islamike. Përveç kësaj, Sabri Koçi ftoi mësimdhënës nga Kosova për të ndihmuar Komunitetin Musliman Shqiptar në dhënien e ligjëratave dhe predikimeve në xhami për muslimanët shqiptarë. Ai e shtroi kërkesën e tij edhe në vende të tjera muslimane, posaçërisht në Arabinë Saudite dhe në Turqi, të cilët ofruan ekspertë në fushën e shkencave Islame, si *Texhvid* (lexim i Kur'anit), *Tefsir* (përkthim/interpretim i Kur'anit), *Akidah* (besimi islam), *Fikh* (jurisprudenca islame), *Sheriat* (ligji islamik) dhe gjuhë arabe.

Punësimi i mësuesve muslimanë vendas dhe të huaj u bë me qëllim që t'u shërbente muslimanëve shqiptarë në përputhje me nevojat e tyre. Disa prej këtyre mësuesve të punësuar përdorën xhamitë për të dhënë mësimet themelore bazë të Islamit. Prioritet iu dha klasave të mësimin të gjuhës arabe, Kur'anit (leximit dhe recitimit), si dhe Sunetit Profetik. Përveç kësaj, një grup prej këtyre mësuesve ishin gjithashtu të punësuar nga organizata të ndryshme islamike për t'u kujdesur për jetimët muslimanë shqiptarë.

Një fushë tjetër, ku Komuniteti Musliman Shqiptar kërkoi kontributin e mësuesve në studimet islamike ishte nëpërmjet hapjes së kurseve të specializuara profesionale, si rrobaqepësia dhe thurja. Përveç dijës profesionale, ata ofruan mësim fetare mbi Akidën (besimin) dhe njohuri të tjera teorike, si dhe njohuri praktike të kryerjes së lutjeve dhe riteve fetare të tjera. Shumë muslimanë, sidomos femrat, u tërhoqën nga këto kurse, gjë që u mundësoi atyre jo vetëm të mësonin për Islamin, por edhe të fillonin ta praktikonin atë rregullisht. Këto kurse u sponsorizuan nga organizata të ndryshme islamike.

(3) Rihapja dhe ndërtimi i xhamive: Muslimanët shqiptarë ishin në një situatë shumë të vështirë për sa i përket objekteve fetare të adhurimit. Sipas disa burimeve, 1600 xhami që funksiononin para komunizmit u shkatërruan, përveç disave që mbijetuan duke u kthyer në dyqane, klube, muze, apo ndërtesa të braktisura⁸. Kështu, ringjallja e mënyrës islame të jetesës u manifestua kryesisht

7 Shiko, Ramiz Zeka, *Xhvillimi i Kulturës Islame te Shqiptarët gjatë Shekullit të XX*, <http://www.iium.edu.my/deed/quran/albanian/kultura.html>, arrihen në Prill 20, 2019.

8 Shiko, Websiti Zyrtar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, *Hafiz Sabri Koçi*, <http://www.kmsh.al/al/2013/06/hafiz-sabri-kocil/>, arrihen në Prill 22, 2019.

me restaurimin e xhamive ekzistuese dhe me ndërtimin e atyre të reja. Disa nga xhamitë ekzistuese u rinovuan dhe disa të tjera veçse u pastruan dhe u rregulluan para se të hapeshin në mënyrë që muslimanët të kryenin ritet e tyre fetare. Fillimisht, Komuniteti Musliman Shqiptar po përballej me kriza financiare në lidhje me mirëmbajtjen e xhamive ekzistuese dhe ndërtimin e të rejave. Për këtë arsye, Hafiz Sabri Koçi ftoi shumë figura dhe personalitete muslimane që të vizitojnë Komunitetin Musliman Shqiptar, ku ata ranë dakord të jepnin mbështetje financiare në formë të donacioneve, të cilat u përdorën për ndërtimin e xhamive, si dhe të medreseve⁹. Përveç pesë namazeve të përditshme, në xhami organizoheshin aktivitete të ndryshme me bazë dijen rreth Islamit. Imamët i mësonin muslimanët në xhami rreth shtyllave të besimit (Besimi në Allah, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, Profetët e Tij, Dita e Gjykimit, dhe Kadaja e Kadari, e mira dhe e keqja), si dhe shtyllave të Islamit (esh-Shehadah - dëshmia për njohjen e Allahut si Zoti i Vetëm dhe Muhammedit si Profeti dhe i Dërguari i Tij; es-Salah - pesë namazet e përditshme; es-Sawm – agjërimi; dhe Haxhi – vizita në Qabe). Këto aktivitete i ndihmuan muslimanët shqiptarë që të zgjerojnë njohuritë e tyre për Islam, si dhe ta praktikojnë atë në jetën e tyre të përditshme.

Reformimi i intelektit, identitetit dhe ndjenjës së përkatësisë Islame

Muslimanët shqiptarë në fillim të viteve 1990 kishin nevojë të madhe për intelektualë muslimanë, të cilët mund t'i përgjigjeshin krizës, me të cilën përballej shoqëria, veçanërisht ajo muslimane në Shqipërinë post-komuniste. Rizgjimi i Islamit midis muslimanëve shqiptarë u ndërpre nga konfliktet politike midis intelektualëve shqiptarë mbi identitetin fetar dhe kombetar të shqiptarëve. Kishte diskutime dhe debate midis intelektualëve shqiptarë që sugjerorin kthimin e të gjithë shqiptarëve, përfshirë muslimanët, në të krishterë. Sipas tyre kjo do të mund të lehtësonte integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian¹⁰. Përveç kësaj, muslimanët shqiptarë u vunë në shënjestër të organizatave të ndryshme islamike që u përkisnin shkollave të ndryshme të mendimit (medhheb), që konkurronin me njëra-tjetrën në lidhje me përhapjen e Islamit dhe mësimet e tij. Komuniteti Musliman Shqiptar e pati shumë të vështirë të monitorojë këtë lloj situatë. Në mes të kësaj, Sabri Koçi dhe përfaqësues të tjerë të Komunitetit Musliman

9 Shiko, Miranda Vicker, *Islam in Albania* (UK: Defence Academy of the United Kingdom, 2008), pp. 1-2.

10 Shiko, Elez Biberaj, *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Boulder: Westview Press, 1998), pp. 210.

Shqiptar menduan se reformimi i intelektit, identitetit dhe ndjenjës së përkatësisë islame do të ishte mënyra më efektive për të ndihmuar muslimanët shqiptarë t'i përgjigjen këtyre sfidave. Reforma u fokusua në: (1) përgatitjen dhe trajnimin e dijetarëve të rinj muslimanë, dhe (2) sigurimin e literaturës islame.

(1) Përgatitja dhe trajnimi i dijetarëve të rinj muslimanë: Që nga fillimi i emërimit të tij si kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar, Hafiz Sabri Koçi vizitoi shumë vende muslimane. Ai kërkoi nga këto vende që të ofrojnë bursa për studentët muslimanë shqiptarë për të ndjekur studimet e tyre në fusha të ndryshme dhe veçanërisht në studimet islamike. Kështu, shumë muslimanë të rinj shqiptarë përfituan bursa të plota. Ata u dërguan jashtë vendit për të marrë njohuri rreth mësimëve themelore të Islamit dhe disiplinave të tjera. Vendet muslimane, si Turqia, Arabia Saudite, Malajzia, Pakistani, Kuvajti, Jordania e tjera, i pranuan ata dhe u bënë shtëpia e tyre e dytë gjatë periudhës së studimit të tyre. Më 12 dhjetor 1992, një grup prej 50 studentësh shqiptarë u dërguan në Universitetin Ndërkombëtar Islamik të Malajzisë, Kuala Lumpur, Malajzi, për të vazhduar studimet e tyre në fusha të ndryshme. Atyre iu ofruan bursa të plota nga organizata bamirëse islamike. Studentë të tjerë u vendosën nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të dijetarëve të shquar shqiptarë të *fikhut* dhe *hadithit*, të cilëve u ishte ndaluar hyrja në Shqipëri nga regjimi komunist dhe jetonin në vende muslimane, si Shejh Nasiruddin Albani dhe Shejh Shuajb Arnauti.

Shumica e dijetarëve të rinj muslimanë, të cilët përfunduan studimet e tyre mbi Islamit dhe shkencat e ndryshme, morën njohuri autentike të mirëfillta që mund të aplikoheshin në mënyrë efektive në çështjet bashkëkohore që përballeshin nga Komuniteti Musliman i Shqipërisë post-komuniste. Reformimi i intelektit të të rinjve muslimanë shqiptarë u mundësoi atyre të forcojnë dhe të kuptojnë rëndësinë e identitetit islam, i cili krijoi për ta ndjenjën e përkatësisë që ishte pothuajse e humbur gjatë 23 viteve të sistemit komunist në Shqipëri.

(2) Sigurimi i literaturës islame: Për 23 vjet muslimanët shqiptarë nuk u lejuan të lexonin ose të posedonin asnjë literaturë të lidhur me Islamit dhe mësimet e tij. Feja në përgjithësi dhe Islami në veçanti, u konsideruan si kërcënim serioz për ideologjinë komuniste. Prandaj, të gjithë ata që u gjetën me posedim të literaturës fetare ose islamike duhej të përballeshin me dënime të ashpra. Ndryshimi i sistemit nga komunizmi në kapitalizëm i gjeti muslimanët shqiptarë në një situatë shumë të varfër në lidhje me literaturën islame, e cila ishte jashtëzakonisht e nevojshme për të siguruar informacionin thelbësor rreth Islamit dhe mësimëve të tij.

Në përputhje me përpjekjet për reformimin e intelektit të muslimanëve shqiptarë, shkrimi dhe botimi i literaturës islame shihej si një domosdoshmëri. Ishte përgjegjësi e përfaqësuesve muslimanë shqiptarë dhe sidomos kryetarit Hafiz

Sabri Koçi për të filluar shkrimin dhe botimin e literaturës islame. Një përpjekje e madhe u bë për përkthimin e shumë librave islamikë dhe trajtesave nga arabishtja ose anglishtja në gjuhën shqipe. U themeluan një numër i madh revistash dhe shumë intelektualë muslimanë kontribuan duke marrë pjesë në shkrimin e artikujve rreth Islamit. Kjo përfshirje shërbeu për të reformuar intelektin dhe mendimin e muslimanëve shqiptarë për të rivendosur identitetin e tyre islam dhe për të krijuar për ta një ndjenjë përkatësie.

Në mënyrë që dituria Islame të arrinte në çdo shtëpi muslimane në Shqipëri, në 1991 Hafiz Sabri Koçi vizitoi Ministrinë Shqiptare të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të kërkuar publikimin e një gazete. Kjo u bë realitet më 10 Janar 1992, kur u botua numri i parë i gazetës “Drita Islame”. Që atëherë, ajo u bë pronë e Komunitetit Musliman Shqiptar duke u botuar çdo dy javë. Kjo gazetë u bë burim informacioni për shumë muslimanë shqiptarë nga klasa të ndryshme shoqërore.

Gjatë viteve 1991 dhe 1992 u botuan gazeta të ndryshme, si “Shkëlqimi Islam”, pronë e Shoqatës Shqiptare të Rinisë Muslimane, e cila u pasua nga gazeta “Shpresa”, pronë e Intelektualëve Muslimanë Shqiptarë, si dhe “Triumfi Islam” që sot quhet “Rinia Islame”, pronë e Shoqatës Shqiptare të Rinisë Muslimane, me një degë në qytetin e Shkodrës. Komuniteti Musliman Shqiptar me ndihmën e Hafiz Sabri Koçit ishte në gjendje të gjejë burime për mbështetje financiare për të botuar libra të vlefshëm mbi jetën e të Dërguarit Muhammed (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), Historisë Islame dhe kopje të versionit të përkthyer të Kur’anit në gjuhën shqipe¹¹.

E gjithë kjo literaturë shërbeu për të edukuar Muslimanët Shqiptarë rreth Islamit dhe mësimet të tij. Muslimanët shqiptarë në përgjithësi dhe rinia muslimane shqiptare në veçanti përfituan jashtë mase nga kjo letërsi, e cila u mundësoi atyre të reformonin intelektin e tyre, të ndryshonin mënyrën e mendimit të tyre dhe të bëheshin jo vetëm muslimanë më të mirë, por edhe qytetarë të denjë shqiptarë. Përveç kësaj, një literaturë e tillë islame u mundësoi muslimanëve shqiptarë që të pajisen me njohuri të plota rreth Islamit, gjë që u siguroi atyre ndjenjën e identitetit dhe përkatësisë.

Texhdidi dhe *Islahu* për rizgimin e Islamit në Shqipërinë post-komuniste duhet të jenë një proces i vazhdueshëm, pasi i ndihmon jo vetëm muslimanët, por edhe të tjerët që të kenë një botëkuptim dhe vetëdije të plotë islame. Mjeti kryesor për arritjen e një qëllimi të tillë është bashkimi i muslimanëve shqiptarë nën flamurin e Islamit të vërtetë të bazuar në dy burimet e tij, Kur’anin dhe Sunetin, duke shmangur dallimet kulturore dhe ndikimet e jashtme. Të rinjtë muslimanë duhet

11 Shiko, Faqen zyrtare të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Hafiz Sabri Koçi, <http://www.kmsh.al/al/2013/06/hafiz-sabri-koci/>, arrihen në Prill 23, 2019.

të angazhohen në sa më shumë aktivitete me natyrë islamike. Kur muslimanët shqiptarë ta kuptojnë Islamit ashtu siç duhet, ata do të mund të jetojnë në mënyrë paqësore me njëri-tjetrin, si dhe me anëtarët e feve të tjera të shoqërisë shqiptare. Kjo do të krijojë një bashkëjetesë paqësore dhe do të forcojë marrëdhëniet midis muslimanëve shqiptarë, si dhe të gjithë qytetarëve të Shqipërisë. Ndjenja e identitetit dhe përkatësisë midis shqiptarëve muslimanë do të krijohet dhe zhvillohet vetëm kur ata të reformojnë intelektin e tyre dhe t'i rikthehen të kuptuarit të drejtë të Islamit.

Përfundim

Ky studim arrin në përfundimin se tendencat e *Texhdidit* dhe *Islahut* për rizgjimin e Islamit në Shqipërinë post-komuniste ofrojnë platformën më të mirë që do të përdoret për promovimin e mësimave islame. Hafiz Sabri Koçi, kryetari i parë i Komunitetit Musliman Shqiptar pas rënies së komunizmit dha një kontribut të madh në restaurimin e institucioneve islamike, objekteve fetare dhe zhvillimit të intelektualëve muslimanë. Për t'i shtyrë dhe më tej këto zhvillime ekziston nevoja për të shmangur konfliktet mes pjesëtarëve të organizatave të ndryshme islamike që veprojnë në Shqipëri nëpërmjet rivendosjes së mësimave islame sipas Kur'anit dhe Sunetit. Ky studim sugjeron studime të mëtejshme që duhet të ndërmerren nga Komuniteti Musliman Shqiptar në lidhje me përpjekjet e tyre drejt qëndrueshmërisë së rilindjes Islame përmes *Texhdidit* dhe *Islahut*.

Referencat

- Arolda Elbasani. (2016). State-Organised Religion and Muslims' Commitment to Democracy in Albania. *Europe-Asia Studies*, Vol. 68, No. 2, pp. 253–269.
- Edwin E. Jacques. (1995). *The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present*. North Carolina & London: McFarland & Company, Inc., Publishers Jefferson.
- Elez Biberaj. (1990). *Albania: A Socialist Maverick*. Boulder, San Francisco, & Oxford: Westview Press.
- Elez Biberaj. (1998). *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*. Boulder: Westview Press.
- Fikret Karčić. (2015). *The Other European Muslims: A Bosnian Experience*. Sarajevo: Center for Advanced Studies.
- Florian Bieber. (2000). Muslim Identity in the Balkans before the Establishment of the Nation State. *Nationalities Papers*, Vol. 28, No. 1.

- George W. Gawrych. (2006). *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874-1913*. London – New York: I.B. Tauris & Co Ltd.
- H.T. Norris. (1993). *Islam in the Balkans: Religion and Society between Europe and the Arab World*. London: Hurst & Co. Publisher, Ltd.
- Hafiz Sabri Koçi, Albanian Muslim Community, <http://www.kmsh.al/all/2013/06/hafiz-sabri-kocil/> (Retrieved on April 17, 2019).
- Medreseja e Shkodrës, më e madhja në Ballkan* (The Madrasah of Shkodra, the biggest in the Balkans), <https://www.trt.net.tr/shqip/kultura-dhe-arti/2018/01/24/medreseja-e-shkodres-me-e-madhja-ne-ballkan-895904>, marrë në 20 Prill, 2019.
- Medreseja e Vajzave në Durrës, Misioni që bashkon Diturinë dhe Besimin* (Girls' Madrasah in Durrës, the mission that integrates between Knowledge and Faith), <https://www.islamjakova.net/arti-kulli.php?id=4605>, marrë në 20 Prill, 2019.
- Miranda Vicker. (2008). *Islam in Albania*. UK: Defence Academy of the United Kingdom.
- Mircea Eliade (ed.). (1986). *The Encyclopedia of Religion*. New York: Macmillan Publishing Company, vol. 1, "Albanian Religion".
- N.K. Singh & A.M. Khan. (ed.). (2001). *Encyclopaedia of the World Muslims: Tribes, Castes and Communities*. Delhi-India: Global Vision Publishing House, vol. 1, "Albanians."
- Ramadan Marmullaku. (1975). *Albania and the Albanians*, translated from Serbo-Croatian by Margot and Bosko Milosavljevic. London: C. Hurst & Co. Publishers, Ltd.
- Ramiz Zeka, *Xhvillimi i Kulturës Islame te Shqiptarët gjatë shekullit të XX* (The Development of Islamic Culture among the Albanians during the 20th century), <http://www.iium.edu.my/deed/quran/albanian/kultura.html>, accessed on 20 April, 2019.
- T.W. Arnold. (2002). *The Preaching of Islam: A History of the Propagation of the Muslim Faith*. New Delhi: Adam Publishers & Distributors, 2nd edition.

Revival of Islam through *Tajdid* (Renewal) and *Islah* (Reform) Tendencies in the Post-Communist Albania

Abstract

This article examines the revival of Islam in Albania through *Tajdid* (renewal) and *Islah* (reform) tendencies carried out by the Albanian Muslim Community and Muslim intellectuals, after the fall of the Communist System, in 1990s. The study intends to show the role of *Tajdid* and *Islah* activities in the restoration of Islam in the post-communist Albania. The significance of this research lies in its highlights of the renewal process of Islam in Albania within the first ten years after the fall of communism. This paper starts with a brief introduction on Albanians and their religious identity and continues with the discussion of: (1) the main factors leading to *Tajdid* and *Islah* in post-communist Albania, (2) the restoration of the Islamic educational institutions and the places of worship, and (3) the reformation of Muslim's intellect, identity and belongingness. Descriptive and analytical methods are utilized. The analysis of this study adds new insights to the exiting literature on *Tajdid* and *Islah* tendencies for the revival of Islam in Albania.

Key words: *Tajdid* (renewal), *Islah* (reform), Albania, post-communism, religious identity